



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.903/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Goran Milenković- Kryetar, z .Nuhi Paçarizi -Referues, z. Blerim Dina- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Milenium Konstruktion Shpk & ANUAR SH.P.K”-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: LOT I: OE “N.P.N Dardania”-Prishtinë, LOT II: OE “NNSH Vaakal”- Podujevë dhe LOT III: grupi i OE-ve “Afrim A Beka B.I. & Alkoimpex-general construction Sh.p.k.” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajta dimërore e rrugëve rurale Lot 1, 2, 3” me nr. të prok:616-19-7786-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- Kuvendi Komunal Prishtinë, më datën:27.12.2019,mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Milenium Konstruktion Shpk & ANUAR SH.P.K”-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajta dimërore e rrugëve rurale Lot 1, 2, 3” me nr. të prok:616-19-7786-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- Kuvendi Komunal Prishtinë.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënien e kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajta dimërore e rrugëve rurale Lot 1,2,3” me nr. të prok:616-19-7786-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal Prishtinë dhe lënda kthehet në **Ri-vlerësim për Lot 1, 2 dhe 3**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Milenium Konstruktion Shpk & ANUAR SH.P.K”-Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimt të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE “Milenium Konstruktion Shpk & ANUAR SH.P.K”-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 10.12.2019 me nr. 903/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajta dimërore e rrugëve rurale Lot 1,2,3” me nr. të prok:616-19-7786-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 7, 59, 60, 61, 64, 69 dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 12.12.2019, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt:17.12.2019, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim: Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 7, 59, 60, 61 dhe 72 të LPP-së, me arsyetimin se: “AK-ja për Lot 1 ka rekomanduar për kontratë OE N.P.N “DRADANIA” i cili është OE i pa përgjegjshëm sepse nuk e posedon listën e makinerisë, gjithashtu OE i lartcekur nuk posedon ngarkues të mëdhenj, por ka vetëm një, i cili është me peshë 5 ton i cili është ngarkues i vogël, ndërsa janë kërkuar dy ngarkues të mëdhenj. Po ashtu ky OE në vend të ngarkueseve ka ofruar dëshmi për ekskavator. AK-ja ka kërkuar sqarime në lidhje për mos dorëzimin e listës së pajisjeve dhe të dëshmoj se cili nga kamionët tjerë për të cilët ka dorëzuar dëshmitë e posedimit është i destinuar për largimin e borës (të dëshmohet me dokument adekuat). Fillimisht autoriteti kontraktues nuk ka pasur

të drejtë të kërkoj sqarime shtesë për shkak se ky OE nuk ka pasur dhe nuk ka ofruar dëshmi sipas kërkesës së AK-së për katër kamion me mekanizëm për largimin e borës dhe për ngarkues, pasi që në vend të ngarkuesve ka ofruar dëshmi eskavator.

OE i rekomanduar për kontratë kur ju ka ofruar sqarimet shtesë AK-së shihet që ka bërë modifikime tek kamionët, e të cilat modifikime e mbajnë datën 22.11.2019, e që rezulton se janë sjell dokumente që mbajnë datën pas hapjes së ofertave, kurse ky fakt bie në kundërshtim me nenin 72.3 të LPP-së, prandaj ky OE duhet të shpallet si i papërgjegjshëm. Autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarim duke kërkuar që OE i rekomanduar për kontratë të dëshmojë se cili nga kamionët tjerë është i destinuar për largimin e borë, mirëpo ky fakt është vërtetuar shumë lehtë nga AK-ja sepse edhe në librezat kanë shënuar se cili është për largimin e borës, por AK-ja i ka krijuar hapësirë këtij operatori ekonomik për të bërë përmirësime dhe ndërhyrje në dëshmitë në lidhje me kamionët të cilat nuk kanë qenë për largimin e borës. Gjithashtu tek kamionët për borë OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar kamionë kiper ndërsa vetëm dy i ka për borë, po ashtu OE N.P.N "DARDANIA" tek lista e çmimeve tek pozicioni nr.2 ka vendosur çmimin për ngarkim 0.50 cent që është çmim jo normalisht i ulët dhe jashtë çmimeve të tregut. Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë nuk ka referenca në vlerën e kërkuar prej 100 mijë euro sepse dy referencat që ka ofruar janë për të njëjtin projekt, që ka filluar punën në vitin 2015, prandaj nuk ka dëshmi të mjaftueshme se ky OE e arrin vlerën e kërkuar në FDT. Gjithashtu OE i lartcekur, ka ofruar një marrëveshje për huazim të një kamioni special 2 dyer, me targa 01-328-HB ngjyrë e portokalltë i cili nuk është për largimin e borës." duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lëndës eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues nuk janë të bazuara sepse operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar dëshmitë të mjaftueshme siç ka kërkuar AK me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit lidhur me lidhur me 2 ngarkuesit ka dorëzuar dëshmi kopjen e DUD doganor R-4297 dt.18.02.2014, DUD- R 6446 dt.03.05.2014 si dhe faturën nr.07/13 e leshur nga kompania Zahir për kompaninë Dardania me dt.02.07.2013. OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar dëshmi librezat e qarkullimit, disa marrëveshje si dhe DUD se posedon 9 kamion për ta plotësuar kërkesën e AK për katër kamion me mekanizëm për largimin e bores dhe me qenë se ne disa nga dëshmitë nuk ka qenë e specifikuar se kamionët kane mekanizëm për largim te bores AK ka kërkuar sqarime për të njëjtit dhe ka pranuar dëshmi shtesë nga OE i rekomanduar për kontrate se te njëjtit janë konform kërkesës se parashtruar. Lidhur me pretendimin e OE ankuese rreth çmimeve jo normalisht te uleta, eksperti shqyrtues sqaron se bazuar ne ofertat e operatoreve ekonomik pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit si dhe sipas rregullores për tenderët jo normalisht te ulet, nuk mund te konstatohet se ndonjëra nga ofertat ne këtë aktivitet te prokurimit është jo normalisht e ulet. Duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lëndës eksperti shqyrtues konstaton se pretendim i operatorit ekonomik ankues AK ka

bërë shkelje te nenit 60 të LLP-së nuk është i bazuara sepse AK ka rekomanduar për kontrate ne LOT I: OE "N.P.N Dardania"-Prishtinë, me ofertë financiare në vlerë prej 51,491.70 € dhe e njëjta është më e lirë për 41,702.17 € se oferta e grupit te OE ankuese "Milenium Konstruktion sh.p.k.&Anuar Sh.p.k."Prishtinë, e cila përmban vlerën e ofertës për LOT I prej 93,193.87 €.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 7, 59, 60 dhe 72 të LPP-së, me arsyetimin se: "Për Lot 2 është rekomanduar për kontratë OE N.N.SH "VAAKALI". Ky operator ekonomik në listën e makinerisë ka ofruar kamion dy dyer 01-618-CP. AK-ja ka kërkuar sqarime në lidhje mungesat e makinerive për këtë OE edhe pse në bazë të dëshmive OE i rekomanduar për kontratë nuk ka arritur të mbulojë kërkesën e AK-së. Fillimisht autoriteti kontraktues nuk ka pasur të drejtë të kërkon sqarime shtesë për shkak se ky OE nuk ka pasur dhe nuk ka ofruar dëshmi sipas kërkesës së AK-së për katër kamion me mekanizëm për largimin e borës dhe për ngarkues, pasi që ka ofruar vetëm një ngarkues. OE i rekomanduar për kontratë kur i ka ofruar sqarimet shtesë AK-së shihet që ka bërë modifikime tek kamionët (kamioni 2635 i vitit 1990 me targa 01-618 CP është modifikuar), të cilat modifikime e mbajnë datën 25.11.2019, e që rezulton se janë sjellë dokumente që mbajnë datën pas hapjes së ofertave, kurse ky fakt bie në kundërshtim me nenin 72.3 prandaj ky OE duhet të shpallet si i papërgjegjshëm. Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë për Lot 2 ka ofruar vetëm 3 kamionë për pastrim bore, ndërsa në kërkesën e AK-së ka qenë: janë kërkuar 4 kamionë me mekanizëm për pastrim bore(plugu) dhe hedhës kripe. Gjithashtu i njëjti OE ka modifikuar edhe kamionin UNIMOG 427/10 viti 1989, ku data e modifikimit është dt.25.11.2019 që d.m.th. është pas datës së hapjes së ofertave. Kamioni Special 2 dyer nuk është për borë: 01-677.EF, përndryshe nëse do të ishte për borë do të shënohej në librezë të regjistrimit. OE i lartcekur është i papërgjegjshëm sepse edhe tek ngarkuesit ka prezantuar vetëm një, edhe pse janë kërkuar dy ngarkues, gjithashtu janë kërkuar sqarime për faturën e bagerit, e Zymer Shabanit, e që realisht pa pasur nevojë është kërkuar sqarime sepse në faturë shihet qartë se ky është bager. Po ashtu ju sqarojmë se Marka OFKL është markë për eskavator e jo për lugë ngarkuese. Gjithashtu OE i lartcekur, ka ofruar kamion special 2 dyer, me targa 01-677.EF i cili nuk është për largimin e borës." duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues nuk janë të bazuara sepse operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar dëshmitë të mjaftueshme siç ka kërkuar AK me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit lidhur me lidhur me 2 ngarkuesit ka dorëzuar dëshmi kopjen e DUD doganor nr.7124 dt.21.04.2011 dhe kontratën e shitblerjes ne mes z. Zymber Shabani dhe OE "Vaakali" te datës 03.02.2007 te përcjellë me DUD- 6800 dt.11.04.2000. OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar dëshmi librezat e qarkullimit, me te dhënat 01-156-IJ, 01-157-IJ, 01-618-CP, 01-677-EF si dhe kamionin

e huazuar 01-924-LL për ta plotësuar kërkesën e AK për katër kamion me mekanizëm për largimin e bores dhe me qenë se ne disa nga dëshmitë nuk ka qenë e specifikuar se kamionët kane mekanizëm për largim te bores AK ka kërkuar sqarime për të njëjtit dhe ka pranuar dëshmi shtesë nga OE i rekomanduar për kontrate se te njëjtit janë konform kërkesës se parashtruar. Duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lendes eksperti shqyrtues konstaton se pretendim i operatorit ekonomik ankues AK ka bërë shkelje të nenit 60 të LLP-së nuk është i bazuara sepse AK ka rekomanduar për kontrate në LOT II: OE “NNSH Vaakal”- Podujevë, me ofertë financiare në vlerë prej 59,017.12 € dhe e njëjta është më e lirë për 26,274.49 € se sa oferta e grupit të OE ankuese “Milenium Konstruktion sh.p.k. & Anuar Sh.p.k.”- Prishtinë, e cila përmban vlerën e ofertës për LOT II prej 85,291.61 €.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 7, 59, 60, 61 dhe 72 të LPP-së, me arsyetimin se: “Për Lot 3 është rekomanduar për kontratë OE ALKO IMPEX & BASHKIMI i cili është i pa përgjegjshëm sepse tek lista e çmimeve tek pozicioni 1 ka ofruar çmim prej 0.002 cent, duke ofruar çmim jo normalisht të ultë dhe çmim jashtë tregut. Është deklaruar një deklaratë e nënshkruar nga OE e cila përmban emrin, mbiemrin dhe pozitën për 25 punëtorë, ndërsa OE nuk e ka ofruar këtë, ndërsa autoriteti kontraktues në kundërshtim me dispozitat e LPP-së ka kërkuar sqarime shtesë. Po ashtu është kërkuar Kamion Frezë, i cili nuk ka pasur dëshmi për këtë pajisje, ndërsa janë kërkuar sqarime shtesë në mënyrë të kundërligjshme dhe pa ndonjë arsye, edhe pse pas sqarimeve OE Alko impex ka ofruar frezë për traktor. Pra ky OE është i papërgjegjshëm. Gjithashtu anëtari i grupit të OE Bashkimi ka ofruar një listë me tre pajisje, por nuk ka ofruar fare dëshmi, prandaj nuk ka të drejtë të kërkohe sqarime.

Grupit të operatorëve ekonomik në fjalë i mungojnë 2 ngarkues të mëdhenj, ndërsa ky OE ka ofruar ekskavator dhe një mini ekskavator për gërmim, por siç edhe e dini ekskavatori dhe ngarkuesit dallojnë ndërmjet vete. Pra edhe ky OE është dashur të shpallet si tenderues i papërgjegjshëm. Ne me dt. 03.12.2019 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje faktike dhe ligjore në pretendimet tona ankimore. Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së. Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 i LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi. Njëkohësisht në kundërshtim me nenin 72 të LPP-së AK-ja ka kërkuar sqarime shtesë edhe pse të gjitha faktet kanë qenë të qarta. Autoriteti kontraktues duhet është dashur ta ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që

dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.” duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lëndës ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues nuk janë të bazuara, sepse lidhur me pretendimin e OE ankuese rreth çmimeve jo normalisht të ulëta, ekspertit shqyrtues sqaron se bazuar në ofertat e operatoreve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit si dhe sipas rregullores për tenderët jo normalisht të ulët, nuk mund të konstatohet se ndonjëra nga ofertat në këtë aktivitet të prokurimit është jo normalisht e ulët. Grupi i Operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë kanë dorëzuar dëshmitë respektivisht dy anëtarët e grupit të OE kanë dorëzuar listat me të dhënat e punëtorëve e që vlen të theksohet se OE “ALKO IMPEX” ka dorëzuar listën me të dhënat e 65 punëtorëve që e tejkalon kërkesën e AK. Grupi i Operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë kanë dorëzuar dëshmitë të mjaftueshme siç ka kërkuar AK me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit me lidhur me 2 ngarkuesit ka dorëzuar dëshmi kopjen e librezave të qarkullimit për tre ngarkues ku dy janë të markës JCB 4CX-SM dhe një i markës JCB 3CX SM. Lidhur me pretendimin e OE ankuese rreth dëshmisë se Kamionit Freze ekspertit shqyrtues sqaron se anëtari i konzorciumit “Bashkimi” ka dorëzuar Listën e Pajisjeve në të cilën ka specifikuar se posedon kamionin freze për heqjen e bores dhe se për të njëjtën AK ka kërkuar sqarime dhe pranuar dëshminë. Duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lëndës ekspertit shqyrtues konstaton se pretendim i operatorit ekonomik ankues AK ka bërë shkelje të nenit 60 të LLP-së nuk është i bazuara sepse AK ka rekomanduar për kontratë në LOT III: grupi i OE “Afrim A Beka B.I. & Alkoimpex-general construction Sh.p.k.”-Prishtinë, me ofertë financiare në vlerë prej 46,214.65 € dhe e njëjta është më e lirë për 35,155.11 € se sa oferta e grupit të OE ankuese “Milenium Konstruktion sh.p.k. & Anuar Sh.p.k.”- Prishtinë, e cila përmban vlerën e ofertes për LOT III prej 81,369.76 €.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 64 dhe 69 të LPP-së duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lëndës, ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues nuk janë të bazuara sepse OE ankuese dispozitat në fjalë vetëm i ka cekur sipërfaqësisht pa sqaruar dhe pa dhënë ndonjë fakt rreth shkeljes së këtyre neneve në deklaratën e ankesës së dorëzuar, po ashtu me nenet 64 dhe 69 të LPP-së, rregullohen respektivisht udhëzohen autoritetet kontraktuese se si duhet të vendosen në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë kërkesat minimale si dhe cilat dëshmi duhet të dorëzohen nga OE lidhur me dëshmitë e kërkesave të parashtruar nga AK, respektivisht se si duhet të vendosen në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë kërkesat minimale dhe dëshmitë që

duhet të dorëzohen lidhur me aftësitë teknike dhe/ose profesionale, gjatë ushtrimit/zhvillimit të një aktiviteti të prokurimit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të hedhet poshtë si e pa bazuar, dhe rekomandon që të mbetet në fuqi njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së.

Operatori Ekonomik, me datë: 18.12.2019, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 27.12.2019, ku ishin prezentë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues përfaqësuesit e OE-së ankuese, përfaqësuesit e AK-së si dhe eksperti shqyrtues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtrësat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z. Fetoshi deklaroi: Të nderuar ju sqarojmë se AK-ja për Lot 1 ka rekomanduar për kontratë OE N.P.N "DRADANIA" i cili është OE i pa përgjegjshëm sepse nuk e posedon listën e makinerisë, gjithashtu OE i lartcekur nuk posedon ngarkues të mëdhenj, por ka vetëm një, i cili është me peshë 5 ton i cili është ngarkues i vogël, ndërsa janë kërkuar dy ngarkues të mëdhenj. Po ashtu ky OE në vend të ngarkueseve ka ofruar dëshmi për ekskavator.

AK-ja ka kërkuar sqarime në lidhje për mos dorëzimin e listës së pajisjeve dhe të dëshmoj se cili nga kamionët tjerë për të cilët ka dorëzuar dëshmitë e posedimit është i destinuar për largimin e borës (të dëshmohet me dokument adekuat). Fillimisht autoriteti kontraktues nuk ka pasur të drejtë të kërkoj sqarime shtesë për shkak se ky OE nuk ka pasur dhe nuk ka ofruar dëshmi sipas kërkesës së AK-së për katër kamion me mekanizëm për largimin e borës dhe për ngarkues, pasi që në vend të ngarkuesve ka ofruar dëshmi eskavator.

OE i rekomanduar për kontratë kur ju ka ofruar sqarimet shtesë AK-së shihet që ka bërë modifikime tek kamionët, e të cilat modifikime e mbajnë datën 22.11.2019, e që rezulton se janë sjell dokumente që mbajnë datën pas hapjes së ofertave, kurse ky fakt bie në kundërshtim me nenin 72.3 të LPP-së, prandaj

ky OE duhet të shpallet si i papërgjegjshëm. Autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarim duke kërkuar që OE i rekomanduar për kontratë të dëshmojë se cili nga kamionët tjerë është i destinuar për largimin e borë, mirëpo ky fakt është vërtetuar shumë lehtë nga AK-ja sepse edhe në librezë kanë shënuar se cili është për largimin e borës, por AK-ja i ka krijuar hapësirë këtij operatori ekonomik për të bërë përmirësime dhe ndërhyrje në dëshmitë në lidhje me kamionët të cilat nuk kanë qenë për largimin e borës.

Gjithashtu tek kamionët për borë OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar kamionë kiper ndërsa vetëm dy i ka për borë, po ashtu OE N.P.N "DRADANIA" tek lista e çmimeve tek pozicioni nr.2 ka vendosur çmimin për ngarkim 0.50 cent që është çmim jo normalisht i ulët dhe jashtë çmimeve të tregut. Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë nuk ka referenca në vlerën e kërkuar prej 100 mijë euro sepse dy referencat që ka ofruar janë për të njëjtin projekt, që ka filluar punën në vitin 2015, prandaj nuk ka dëshmi të mjaftueshme se ky OE e arrin vlerën e kërkuar në FDT. Gjithashtu OE i lartcekur, ka ofruar një marrëveshje për huazim të një kamioni special 2 dyer, me targa 01-328-HB ngjyrë e portokalltë i cili nuk është për largimin e borës.

Për Lot 2 është rekomanduar për kontratë OE N.N.SH "VAAKALI". Ky operator ekonomik në listën e makinerisë ka ofruar kamion dy dyer 01-618-CP. AK-ja ka kërkuar sqarime në lidhje mungesat e makinerive për këtë OE edhe pse në bazë të dëshmive OE i rekomanduar për kontratë nuk ka arritur të mbulojë kërkesën e AK-së.

Fillimisht autoriteti kontraktues nuk ka pasur të drejtë të kërkon sqarime shtesë për shkak se ky OE nuk ka pasur dhe nuk ka ofruar dëshmi sipas kërkesës së AK-së për katër kamion me mekanizëm për largimin e borës dhe për ngarkues, pasi që ka ofruar vetëm një ngarkues.

OE i rekomanduar për kontratë kur i ka ofruar sqarimet shtesë AK-së shihet që ka bërë modifikime tek kamionët (kamioni 2635 i vitit 1990 me targa 01-618 CP është modifikuar), të cilat modifikime e mbajnë datën 25.11.2019, e që rezulton se janë sjellur dokumente që mbajnë datën pas hapjes së ofertave, kurse ky fakt bie në kundërshtim me nenin 72.3 prandaj ky OE duhet të shpallet si i papërgjegjshëm. Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë për Lot 2 ka ofruar vetëm 3 kamionë për pastrim bore, ndërsa në kërkesën e AK-së ka qenë: janë kërkuar 4 kamionë me mekanizëm për pastrim bore(plugu) dhe hedhës kripe. Gjithashtu i njëjti OE ka modifikuar edhe kamionin UNIMOG 427/10 viti 1989, ku data e modifikimit është dt.25.11.2019 që d.m.th. është pas datës së hapjes së ofertave. Kamioni Special 2 dyer nuk është për borë: 01-677.EF, përndryshe nëse do të ishte për borë do të shënohej në librezë të regjistrimit. OE i lartcekur është i papërgjegjshëm sepse edhe tek ngarkuesit ka prezantuar vetëm një, edhe pse janë kërkuar

dy ngarkues, gjithashtu janë kërkuar sqarime për faturën e bagerit, e Zymer Shabanit, e që realisht pa pasur nevojë është kërkuar sqarime sepse në faturë shihet qartë se ky është bager. Po ashtu ju sqarojmë se Marka OFKL është markë për eskavator e jo për lugë ngarkuese. Gjithashtu OE i lartcekur, ka ofruar kamion special 2 dyer, me targa 01-677.EF i cili nuk është për largimin e borës

Për Lot 3 është rekomanduar për kontratë OE ALKO IMPEX & BASHKIMI i cili është i pa përgjegjshëm sepse tek lista e çmimeve tek pozicioni 1 ka ofruar çmim prej 0.002 cent, duke ofruar çmim jo normalisht të ultë dhe çmim jashtë tregut.

Është deklaruar një deklaratë e nënshkruar nga OE e cila përmban emrin, mbiemrin dhe pozitën për 25 punëtorë, ndërsa OE nuk e ka ofruar këtë, ndërsa autoriteti kontraktues në kundërshtim me dispozitat e LPP-së ka kërkuar sqarime shtesë. Po ashtu është kërkuar Kamion Frezë, i cili nuk ka pasur dëshmi për këtë pajisje, ndërsa janë kërkuar sqarime shtesë në mënyrë të kundërligjshme dhe pa ndonjë arsye, edhe pse pas sqarimeve OE Alko impex ka ofruar frezë për traktor. Pra ky OE është i papërgjegjshëm.

Gjithashtu anëtar i grupit të OE Bashkimi ka ofruar një listë me tre pajisje, por nuk ka ofruar fare dëshmi, prandaj nuk ka të drejtë të kërkohe sqarime. Grupit të operatorëve ekonomik në fjalë i mungojnë 2 ngarkues të mëdhenj, ndërsa ky OE ka ofruar ekskavator dhe një mini ekskavator për gërmim, por siç edhe e dini ekskavatori dhe ngarkuesit dallojnë ndërmjet vete. Pra edhe ky OE është dashur të shpallet si tenderues i papërgjegjshëm.

Ju njoftojmë se nuk pajtohem me konstatimet e ekspertit profesional sepse i njëjti ekspert ka bërë një ekspertizë shumë sipërfaqësore duke mos u marr me pretendimet tona të cilat i kemi precizuar në detaje. P.sh eksperti profesional në lidhje me dëshmitë për OE e rekomanduar për kontratë për Lot 1, sa i përket kërkesës për 4 kamion me mekanizëm shkruan se me sqarime shtesë ka ofruar dëshmi shtesë të mjaftueshme, mirëpo nuk specifikon saktë se çka është ofruar dhe nuk e specifikon fare se dëshmitë për modifikime të këtyre pajisjeve e mbajnë datën 22.11.2019.

Gjithashtu eksperti shkruan se OE i rekomanduar për kontratë për Lot 2 ka ofruar sqarime në lidhje me kamionët dhe se i njëjti ka ofruar dëshmi të mjaftueshme sipas kërkesës së AK-së, mirëpo nuk jep përgjigje në pretendimin tonë se janë modifikuar dëshmitë për kamion dhe se mbajnë datën 25.11.2019, pas datës së fundit për dorëzim të ofertave.

Po ashtu edhe për OE e rekomanduar për Lot 3 eksperti profesional shkruan se ka ofruar sqarime shtesë për frezë sipas kërkesës së AK-së, mirëpo ky konstatim është i pasqaruar dhe nuk është i saktë, sepse edhe pas sqarimeve shtesë i njëjti operator ekonomik ka ofruar frezë për traktor e jo për kamion.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e AK-së znj. Bajrami deklaroj: Autoriteti Kontraktues qëndron mbrapa mendimit të ekspertit dhe hedh poshtë pretendimet e OE ankues duke i cilësuar si te pa bazuara pretendimet e tij.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Krasniqi deklaroj: Qëndroj mbrapa raportit të ekspertizës. Sa i përket modifikimeve të sqarimeve, ekzistojnë fakte se janë shkresat e datave siç e tha përfaqësuesi i OE se, të gjitha të fotografuara janë të bashkangjitura në platformë të e-prokurimit vetëm shihet qartë se disa nga kamionët kanë qenë të modifikuar, ndërsa me rastin e sqarimit OE kanë modifikuar disa dëshmi, sa i përket çmime jo normalisht të ultë mendoj se nuk mund të merren për bazë në rastin kontrate sepse të gjithë OE-të përmbajnë vlera të afërta me përjashtim të OE ankues që ka vlera më të larta me të gjithë OE-të e tjerë në këtë AP dhe është përafërsisht 50 % më i shtrenjti si të tjerët.

Përfaqësuesi i OE-se shtoj: Sa i përket modifikimit desha të sqaroj se në dokumentet që kanë ofruar OE-të ka shënuar Kamion kiper ndërsa e kanë shndërruar për Kamion të bores, pas datës së hapjes së ofertave është bërë modifikimi.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z. Fetoshi deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues të aprovohet ankesa jone si e bazuar për të 3 lotët dhe ky AP kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së znj. Bajrami deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues të hedhë poshtë ankesën e OE ankues si të pa bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues "Milenium Konstruktion Shpk & Anuar" Sh.p.k Prishtinë se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 1, 7, 59, 60, 61 dhe 72 të LPP-së, me arsyetimin se: "Autoriteti kontraktues për Lot 1 ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik N.P.N "DRADANIA" i cili është OE i pa përgjegjshëm sepse nuk e posedon listën e makinerisë, gjithashtu OE i lartpërmendur nuk posedon ngarkues të mëdhenj, por ka vetëm një, i cili është me peshë 5 ton i cili është ngarkues i vogël, ndërsa janë kërkuar dy ngarkues të mëdhenj. Më tej OE ankues shton se ky OE në vend

të ngarkueseve ka ofruar dëshmi për ekskavator. AK-ja ka kërkuar sqarime në lidhje për mos dorëzimin e listës së pajisjeve dhe të dëshmoj se cili nga kamionët tjerë për të cilët ka dorëzuar dëshmitë e posedimit është i destinuar për largimin e borës (të dëshmohet me dokument adekuat). Fillimisht autoriteti kontraktues nuk ka pasur të drejtë të kërkoj sqarime shtesë për shkak se ky OE nuk ka pasur dhe nuk ka ofruar dëshmi sipas kërkesës së AK-së për katër kamion me mekanizëm për largimin e borës dhe për ngarkues, pasi që në vend të ngarkuesve ka ofruar dëshmi eskavator. Tutje, OE ankues potencon se OE i rekomanduar për kontratë kur ka ofruar sqarime shtesë AK-së, shihet që ka bërë modifikime tek kamionët, e të cilat modifikime e mbajnë datën 22.11.2019, e që rezulton se janë sjell dokumente që mbajnë datën pas hapjes së ofertave, kurse ky fakt bie në kundërshtim me nenin 72.3 të LPP-së, prandaj ky OE duhet të shpallet si i papërgjegjshëm. Autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarim duke kërkuar që OE i rekomanduar për kontratë të dëshmojë se cili nga kamionët tjerë është i destinuar për largimin e borë, mirëpo ky fakt është vërtetuar shumë lehtë nga AK-ja sepse edhe në librezë kanë shënuar se cili është për largimin e borës, por AK-ja i ka krijuar hapësirë këtij operatori ekonomik për të bërë përmirësime dhe ndërhyrje në dëshmitë në lidhje me kamionët të cilat nuk kanë qenë për largimin e borës. Më tej, OE ankues shton se tek kamionët për borë, OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar kamionë kiper ndërsa vetëm dy i ka për borë, po ashtu OE N.P.N "DRADANIA" tek lista e çmimeve tek pozicioni nr.2 ka vendosur çmimin për ngarkim 0.50 cent që është çmim jo normalisht i ulët dhe jashtë çmimeve të tregut. Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë nuk ka referenca në vlerën e kërkuar prej 100 mijë euro sepse dy referencat që ka ofruar janë për të njëjtin projekt, që ka filluar punën në vitin 2015, prandaj nuk ka dëshmi të mjaftueshme se ky OE e arrin vlerën e kërkuar në FDT. Gjithashtu OE i lartcekur, ka ofruar një marrëveshje për huazim të një kamioni special 2 dyer, me targa 01-328-HB ngjyrë e portokalltë i cili nuk është për largimin e borës."

Paneli Shqyrtues shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizës konkrete, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi sqaron se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara, sepse lidhur me pretendimin e OE ankuese rreth çmimeve jo normalisht te ulëta, konstaton se oferta e tenderuesit të shpallur fitues N.P.N "DARDANIA" për Llot 1 i përmbushin në tërësi të gjitha kushtet ligjore nga neni 3.1 pika i, ii, iii) të Rregullorës për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët dhe nenit 61 të LPP-së dhe si rrjedhojë oferta e tij duhet të trajtohet dhe konsiderohet ofertë jo-normalisht e ulët dhe duhet të refuzohet si tender jo –normalisht i ulët. Pra paneli shqyrtues konstaton se oferta e OE N.P.N "DARDANIA" për Llot 1 është e papërgjegjshme. (shih kalkulimin sipas formulës për çmime jo-normalisht të ulëta në tabelën nr.1)

Lot 1- Tenderuesi i rekomanduar me kontratë OE NPN DARDANIA				
Nr.	A	B	C	D
1	kushti 1 - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 9 oferta	Pranuar 9 oferta		
2		1.AFRIM BEKA B.I& ALKO IMPEX	55,497.22	
3		2. ZUKA COMMERCE	95,504.43	
4		3.TOIFOR SHPK	87,916.51	
5		4.INTEGRAL SHPK	91,664.91	
6		5.MILENIM		
7		KONSTRUKSION&ANUAR SHPK	93,193.87	
8		6.DARDANIA NPN	51,491.7	
9		7.V.Z COMPANY SHPK	83,221.54	
10		8.EL-BAU SHPK	67,621.70	
11		9.VAAKAL NNSH	75,226.58	
11		Total (C2+C3+C4+C5+C6+C7+C8+C9+C10)	701,338.46	
12		mesatarja (C11/9)	77,926.49	
13	kushti 2 - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	pragu 30% (mesatarja /1.3)	59,943.45	ne ketë rast oferta B1,dhe B6 përmbush kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete
14	kushti 3 – pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire	pragu 10% (oferta e dyte /1.1)	61,474.27	ne ketë rast oferta B1,dhe B6 përmbush edhe kushtin e trete

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar me shume se 3 oferta	Është plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 9 oferta
2	Çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm	Oferta e 6 e plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve. Shih pragun ne kolonën C13
3	Çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët	Oferta e dyte plotëson edhe kushtin e trete (10%) sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shume se 10% me i ulet. Shih pragun C14
Konkludim		Oferta me nr. rendor B1,dhe B6 plotësojnë 3 kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhoje mund te konsiderohet si oferte abnormalisht e ulet

Sa i përket pretendimeve tjera, konform ekspertit profesional te prokurimit paneli shqurtues konstaton se nuk janë pjeserisht të bazuara për faktin se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar dëshmitë të mjaftueshme siç ka kërkuar AK me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Kjo për faktin se, lidhur me dy (2) ngarkuesit ka dorëzuar dëshmi kopjen e DUD doganor R-4297 dt.18.02.2014, DUD- R 6446 dt.03.05.2014 si dhe faturën nr.07/13 e lëshuar nga kompania “Zahiri” për kompaninë “Dardania” me dt.02.07.2013. Po ashtu, OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar dëshmi librezat e qarkullimit, disa marrëveshje si dhe DUD se posedon 9 kamion për ta plotësuar kërkesën e AK për katër kamion me mekanizëm për largimin e borës dhe me qenë se në disa nga dëshmitë nuk ka qenë e

specifikuar se kamionët kanë mekanizëm për largim të borës, AK ka kërkuar sqarime për të njëjtit dhe ka pranuar dëshmi shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë se të njëjtit janë konform kërkesës se parashtruar.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues "Milenium Konstruktion Shpk & Anuar" Sh.p.k Prishtinë se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 1, 7, 59, 60, 61 dhe 72 të LPP-së, me arsyetimin se: "Për Lot 2 është rekomanduar për kontratë OE N.N.SH "VAAKALI". Ky operator ekonomik në listën e makinerisë ka ofruar kamion dy dyer 01-618-CP. AK-ja ka kërkuar sqarime në lidhje mungesat e makinerive për këtë OE edhe pse në bazë të dëshmive OE i rekomanduar për kontratë nuk ka arritur të mbulojë kërkesën e AK-së. Fillimisht autoriteti kontraktues nuk ka pasur të drejtë të kërkon sqarime shtesë për shkak se ky OE nuk ka pasur dhe nuk ka ofruar dëshmi sipas kërkesës së AK-së për katër kamion me mekanizëm për largimin e borës dhe për ngarkues, pasi që ka ofruar vetëm një ngarkues. Më tej, OE ankues shton se OE i rekomanduar për kontratë kur i ka ofruar sqarimet shtesë AK-së shihet që ka bërë modifikime tek kamionët (kamioni 2635 i vitit 1990 me targa 01-618 CP është modifikuar), të cilat modifikime e mbajnë datën 25.11.2019, e që rezulton se janë sjellë dokumente që mbajnë datën pas hapjes së ofertave, kurse ky fakt bie në kundërshtim me nenin 72.3 prandaj ky OE duhet të shpallet si i papërgjegjshëm. Gjithashtu, OE i rekomanduar për kontratë për Lot 2 ka ofruar vetëm 3 kamionë për pastrim bore, ndërsa në kërkesën e AK-së ka qenë: janë kërkuar 4 kamionë me mekanizëm për pastrim bore(plugu) dhe hedhës kripe. Tutje, OE ankues shton se i njëjti OE ka modifikuar edhe kamionin UNIMOG 427/10 viti 1989, ku data e modifikimit është dt.25.11.2019 që d.m.th. është pas datës së hapjes së ofertave. Kamioni Special 2 dyer nuk është për borë: 01-677.EF, përndryshe nëse do të ishte për borë do të shënohej në librezë të regjistrimit. OE i lartcekur është i papërgjegjshëm sepse edhe tek ngarkuesit ka prezantuar vetëm një, edhe pse janë kërkuar dy ngarkues, gjithashtu janë kërkuar sqarime për faturën e bagerit, e Zymer Shabanit, e që realisht pa pasur nevojë është kërkuar sqarime sepse në faturë shihet qartë se ky është bager. Më tej, OE ankues shton se Marka OFKL është markë për eskavator e jo për lugë ngarkuese. Gjithashtu OE i lartcekur, ka ofruar kamion special 2 dyer, me targa 01-677.EF i cili nuk është për largimin e borës."

Paneli Shqyrtues shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizës konkrete, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi sqaron se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara, sepse lidhur me pretendimin e OE ankuese rreth çmimeve jo normalisht të ulëta, konstaton se oferta e tenderuesit të shpallur fitues VAAKAL NNSH për Llot 2 i përmbushen në tërësi të gjitha kushtet ligjore nga neni 3.1 pika i, ii, iii) të Rregullorës për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët dhe nenit 61 të LPP-së

dhe si rrjedhojë oferta e tij duhet të trajtohet dhe konsiderohet ofertë jo-normalisht e ulët dhe duhet të refuzohet si tender jo –normalisht i ulët. Pra paneli shqyrtues konstaton se oferta e OE VAAKAL NNSH” për Llot 2 është e papërgjegjshme. (shih kalkulimin formulës për çmime jo-normalisht të ulëta në tabelën nr.2)

Lot 2- Tenderuesi 1: VAAKAL NNSH				
Nr.	A	B	C	D
1	kushti 1 - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 8 oferta	Pranuar 8 oferta		
2		1.AFRIM BEKA B.I& ALKO IMPEX	55,405.13	
3		2. ZUKA COMMERCE	89,742.20	
4		3.TOIFOR SHPK	87,829.70	
5		4.INTEGRAL SHPK	88,033.61	
6		5.MILENIM		
7		KONSTRUKSION&ANUAR SHPK	85,291.61	
8		6.DARDANIA NPN	71,312.18	
9		7.V.Z COMPANY SHPK	82,754.59	
10		8.VAAKAL NNSH	59,017.12	
11		Total (C2+C3+C4+C5+C6+C7+C8+C9)	619,386.14	
12	kushti 2 - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	mesatarja (C10/8)	77,423.26	ne ketë rast oferta B1,dhe B8 përmbush kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete
13	kushti 3 – pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire	pragu 30% (mesatarja /1.3)	59,556.35	ne ketë rast oferta B1,dhe B8 përmbush edhe kushtin e trete
		pragu 10% (oferta e dyte /1.1)	64,829.25	

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar me shume se 3 oferta	Është plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta
2	Çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm	Oferta e 8 plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve. Shih prapun ne kolonën C12
3	Çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët	Oferta e dyte plotëson edhe kushtin e trete (10%) sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shume se 10% me i ulet. Shih prapun C13
Konkludim		Oferta me nr. rendor B1,dhe B8 plotësojnë 3 kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhoje mund te konsiderohet si oferte abnormalisht e ulet

Sa i përket pretendimeve tjera, paneli shqyrtues konform ekspertit profesional te prokurimit konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues nuk janë të bazuara për faktin se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar dëshmitë të mjaftueshme siç ka kërkuar AK me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit lidhur me lidhur me 2 ngarkuesit ka dorëzuar dëshmi kopjen e DUD

doganor nr.7124 dt.21.04.2011 dhe kontratën e shitblerjes në mes z. Zymber Shabani dhe OE "Vaakali" të datës 03.02.2007 të përcjell me DUD- 6800 dt.11.04.2000. OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar dëshmi librezat e qarkullimit, me të dhënat 01-156-IJ, 01-157-IJ, 01-618-CP, 01-677-EF si dhe kamionin e huazuar 01-924-LL për ta plotësuar kërkesën e AK për katër kamion me mekanizëm për largimin e bores dhe me qenë se në disa nga dëshmitë nuk ka qenë e specifikuar se kamionët kanë mekanizëm për largim të borës AK ka kërkuar sqarime për të njëjtit dhe ka pranuar dëshmi shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë se të njëjtit janë konform kërkesës se parashtruar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Milenium Konstruktion" sh.p.k. & Anuar Sh.p.k."- Prishtinë, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 7, 59, 60, 61 dhe 72 të LPP-së, me arsyetimin se: "Për Lot 3 është rekomanduar për kontratë OE ALKO IMPEX & BASHKIMI i cili është i pa përgjegjshëm sepse tek lista e çmimeve tek pozicioni 1 ka ofruar çmim prej 0.002 cent, duke ofruar çmim jo normalisht të ultë dhe çmim jashtë tregut. Është deklaruar një deklaratë e nënshkruar nga OE e cila përmban emrin, mbiemrin dhe pozitën për 25 punëtorë, ndërsa OE nuk e ka ofruar këtë, kurse autoriteti kontraktues në kundërshtim me dispozitat e LPP-së ka kërkuar sqarime shtesë. Më tej OE ankues shton se është kërkuar Kamion Frezë, i cili nuk ka pasur dëshmi për këtë pajisje, ndërsa janë kërkuar sqarime shtesë në mënyrë të kundërligjshme dhe pa ndonjë arsye, edhe pse pas sqarimeve OE Alko impex ka ofruar frezë për traktor. Pra ky OE është i papërgjegjshëm. Gjithashtu anëtari i grupit të OE Bashkimi ka ofruar një listë me tre pajisje, por nuk ka ofruar fare dëshmi, prandaj nuk ka të drejtë të kërkohe sqarime. Tutje, OE ankues shton se grupit të operatorëve ekonomik në fjalë i mungojnë 2 ngarkues të mëdhenj, ndërsa ky OE ka ofruar ekskavator dhe një mini ekskavator për gërmim, por siç edhe e dini ekskavatori dhe ngarkuesit dallojnë ndërmjet vete. Pra, edhe ky OE është dashur të shpallet si tenderues i papërgjegjshëm. Ne me dt. 03.12.2019 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje faktike dhe ligjore në pretendimet tona ankimore. Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së. Tutje, OE ankues shton se AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 i LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi. Njëkohësisht në kundërshtim me nenin 72 të LPP-së AK-ja ka kërkuar sqarime shtesë edhe pse të gjitha faktet kanë qenë të qarta. Autoriteti kontraktues duhet është dashur ta ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të

fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.”

Paneli Shqyrtues shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizës konkrete, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi sqaron se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara, sepse lidhur me pretendimin e OE ankuese rreth çmimeve jo normalisht të ulëta, konstaton se oferta e tenderuesit të shpallur fitues për Llot 3 ALKO IMPEX&BASHKIM” i përmbushin në tërësi të gjitha kushtet ligjore nga neni 3.1 pika i, ii, iii) të Rregullorës për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët dhe nenit 61 të LPP-së dhe si rrjedhojë oferta e tij duhet të trajtohet dhe konsiderohet ofertë jo-normalisht e ulët dhe duhet të refuzohet si tender jo –normalisht i ulët. Pra paneli shqyrtues konstaton se oferta e ALKO IMPEX&BASHKIM” për Llot 3 është e papërgjegjshme. (shih kalkulimin sipas formulës për çmime jo-normalisht të ulëta në tabelën nr.3)

Lot 3- Tenderuesi 9: AFRIM BEKA B.I& ALKO IMPEX				
Nr.	A	B	C	D
1	kushti 1 - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 9 oferta	Pranuar 9 oferta		
2		1.AFRIM BEKA B.I& ALKO IMPEX	46,214.65	
3		2. ZUKA COMMERCE	96,196.63	
4		3.TOIFOR SHPK	86,725.77	
5		4.INTEGRAL SHPK	84,644.23	
6		5.MILENIM		
7		KONSTRUKSION&ANUAR SHPK	81,369.76	
8		6.DARDANIA NPN	62,943.91	
9		7.EL-BAU SHPK	84,491.98	
10		8.V.Z COMPANY SHPK	81,999.30	
11		9.VAAKAL NNSH	56,975.11	
11		Total (C2+C3+C4+C5+C6+C7+C8+C9+C10)	597,069.36	
12		mesatarja (C11/9)	74,633.67	
13	kushti 2 - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte			ne ketë rast oferta B1,dhe B9 përmbush kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete
		pragu 30% (mesatarja /1.3)	57,410.51	
14	kushti 3 – pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire			ne ketë rast oferta B1, përmbush edhe kushtin e trete
		pragu 10% (oferta e dyte /1.1)	57,221.73	

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar me shume se 3 oferta	Është plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 9 oferta
2	Çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i	Oferta e 1 plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulet se mesatarja

	tenderëve të përgjegjshëm	e tenderëve. Shih pragun ne kolonën C13
3	Çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët	Oferta e dytë plotëson edhe kushtin e trete (10%) sepse ne krahasim me ofertën e dytë me radhe është me shume se 10% me i ulet. Shih pragun C14
Konkludim		Oferta me nr. rendor B1, plotësojnë 3 kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhojë mund të konsiderohet si oferte abnormalisht e ulët

Sa i përket pretendimeve tjera, konform ekspertit profesional të prokurimit paneli shqyrtues konstaton se nuk janë të bazuara sepse grupi i Operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë kanë dorëzuar dëshmitë, respektivisht dy anëtarët e grupit të OE kanë dorëzuar listat me të dhënat e punëtoreve e që vlen të theksohet se OE “ALKO IMPEX” ka dorëzuar listën me të dhënat e 65 punëtoreve që e tejkalon kërkesën e AK. Grupi i Operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë kanë dorëzuar dëshmitë të mjaftueshme siç ka kërkuar AK me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit lidhur me 2 ngarkuesit ka dorëzuar dëshmi kopjen e librezave të qarkullimit për tre ngarkues, ku dy janë të markës JCB 4CX-SM dhe një i markës JCB 3CX SM. Lidhur me pretendimin e OE ankues “Milenium Konstruktion” sh.p.k. & Anuar Sh.p.k.”- Prishtinë rreth dëshmisë se Kamionit Freze, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se anëtari i konzorciumit “Bashkimi” ka dorëzuar Listën e Pajisjeve në të cilën ka specifikuar se posedon kamionin freze për heqjen e borës dhe se për të njëjtën, AK ka kërkuar sqarime dhe pranuar dëshminë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Milenium Konstruktion” sh.p.k. & Anuar Sh.p.k.”- Prishtinë, se AK ka bërë shkelje të nenit 64 dhe 69 të LPP-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues nuk janë të bazuara sepse OE ankues, dispozitat në fjale vetëm i ka cekur sipërfaqësisht pa sqaruar dhe pa dhënë ndonjë fakt rreth shkeljes së këtyre neneve në deklaratën e ankesës së dorëzuar. Po ashtu, me nenet 64 dhe 69 të LPP-së, rregullohen respektivisht udhëzohen autoritetet kontraktuese se si duhet të vendosen në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, kërkesat minimale si dhe cilat dëshmi duhet të dorëzohen nga OE lidhur me dëshmitë e kërkesave të parashtruar nga AK, respektivisht se si duhet të vendosen në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, kërkesat minimale dhe dëshmitë që duhet të dorëzohen lidhur me aftësitë teknike dhe/ose profesionale, gjatë ushtrimit/zhvillimit të një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion, si dhe në sqarimet e ekspertit profesional të prokurimit, vjen në përfundim se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 dhe 61 të LPP-së dhe Rregullorës për Tenderë Jo-Normalisht të Ulët dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së duke rekomanduar për kontratë operatorët

ekonomik me tender jo-normalisht të ulët të cilët nuk kanë plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që gjatë ri-vlerësimit të merr për bazë nenin 3.1 të Rregullave për Tenderët Jo-Normalisht të ulët dhe njëkohësisht t'i trajtojë në mënyrë të barabartë të gjithë ofertuesit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Kuvendi Komunal Prishtinë

1x1 OE-"Milenium Konstruktion Shpk & ANUAR SH.P.K"-Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.